



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 141, dt. 15.06.2016

Në mbështetje të nenit 24, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.06.2016, pasi shqyrtoi propozimet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, lidhur me rishikimin e vendimit nr.7, dt.16.10.2006 të KKR, pika III e këtij vendimi ” Miratimin në unanimitet të heqjes nga lista e Monumenteve të Kulturës të atyre objekteve, që lidhen me ngjarje dhe figura të veprimtarisë së Partisë Komuniste Shqiptare dhe nuk kanë vlerë arkitekturore”,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit për heqjen e statusit monument kulture për objektin “Shtëpia muze ku u themelua P.K.SH, Lagjja "8 Nëntori"”, Tiranë.
2. Miratimin e heqjes së statusit “ Zona Muze-Zona përreth shtëpisë muze ku u formua P.K.SH dhe zona e mbrojtur (Ansambli i rrugës "Formimi i Partisë" që përfshihet midis rrugëve "4 Dëshmoret", "Riza Cerova", "Bajram Curri" dhe "Thanas Ziko" e shpallur zonë e mbrojtur si dhe zona përreth shtëpisë muze ku u formua P.K.SH, e shpallur zonë muze, në Tiranë).
3. T’i propozojë Ministrit të Kulturës heqjen e statusit monument, Zonë Muze dhe Zonë e Mbrojtur referuar pikës 1 dhe 2.
4. Objektet e tjera të vendimit nr.7, dt.16.10.2006 të KKR, do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës.
5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI